



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 192

Tiranë – E hënë, 9 nëntor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 115/2015 datë 22.10.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës, me shkëmbim notash, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Japonisë për furnizimin me automjete të gjeneratës së ardhshme, miqësore ndaj mjedisit..... 12813
Ligj nr. 116/2015 datë 22.10.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, “Përfituesi”, e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, “Agjencia Zbatuese e Projektit”, dhe KfW Frankfurt Am Main, “KfW”, për përgatitjen e projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale..... 12820
Dekret i Presidentit nr. 9294, datë 30.10.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 12825
Dekret i Presidentit nr. 9295, datë 30.10.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12826
	Saktësim gabimi material..... 12826



LIGJ
Nr. 115/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË NDIHMËS, ME SHKËMBIM
NOTASH, NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË JAPONISË PËR
FURNIZIMIN ME AUTOMJETE TË
GJENERATËS SË ARDHSHME,
MIQËSORE NDAJ MJEDISIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e ndihmës, me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë, për furnizimin me automjete të gjeneratës së ardhshme, miqësore ndaj mjedisit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.10.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9306, datë 3.11.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

(Nota shqip)

(Tiranë, 29 korrik 2015)

Shkëlqesi,

Kam nderin t'ju konfirmoj marrjen e Notës së Shkëlqesisë Suaj, në datën e sotme, tek e cila lexohet si më poshtë:

“Kam nderin t'u referohem diskutimeve të fundit të zhvilluara ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë së Japonisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik japonez, me synim forcimin e marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit

midis dy vendeve dhe në emër të qeverisë së Japonisë, të propozoj marrëveshjen në vijim:

1. Me qëllim dhënien e kontributit për nxitjen e përpjekjeve për zhvillim ekonomik dhe social të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, qeveria e Japonisë, në përputhje me të gjitha rregullat e ligjet përkatëse japoneze, i ofron qeverisë së Republikës së Shqipërisë një grant prej pesëqind milionë jenësh japonezë (¥ 500,000,000) (më poshtë i referuar si “Granti”).

2. 1) Granti dhe interesi i akumuluar mbi të përdoren nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë në mënyrë të përshtatshme dhe vetëm për blerjen e produkteve dhe shërbimeve të renditura në listën për të cilën palët përkatëse të dy qeverive do të bien dakord reciprokisht, me kusht që këto produkte të prodhohen dhe këto shërbime të ofrohen nga vendet e pranueshme të origjinës, si edhe për blerjen e shërbimeve shoqëruese të produkteve dhe shërbimeve në fjalë.

2) Lista e përmendur në nënparagrafin 1 më sipër do t'u nënshtrohet ndryshimeve për të cilat mund të bien dakord autoritetet përkatëse të dy qeverive.

3) Shtirja e vendeve të pranueshme të origjinës, të përmendura në nënparagrafin 1 më sipër, do të përcaktohet me marrëveshje ndërmjet autoriteteve përkatëse të dy qeverive.

3. 1) Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të hapë një llogari depozite të zakonshme në një bankë në Japoni, në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë (më poshtë e referuar si “Llogaria”), brenda katërmëdhjetë ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe do të njoftojë me shkrim qeverinë e Japonisë për përfundimin e procedurave për hapjen e Llogarisë brenda shtatë ditëve pas ditës së hapjes së Llogarisë.

2) Qëllimi i vetëm i Llogarisë është pagesa në jenë japonezë nga qeveria e Japonisë e pagesës së përmendur në paragrafin 4, si edhe kryerja e pagesave të nevojshme për blerjen e produkteve dhe shërbimeve të përmendura në nënparagrafin 1, të paragrafit 2, si dhe pagesa të tjera për të cilat kanë rënë dakord autoritetet përkatëse të dy qeverive.

4. Qeveria e Japonisë e ekzekuton Grantin duke kryer pagesën e shumës së përmendur në paragrafin 1 në jenë japonezë gjatë periudhës midis datës së marrjes së njoftimit, të përmendur në nënparagrafin 1 të paragrafit 3 dhe 31 marsit



2015. Kjo periudhë mund të shtyhet me marrëveshje të ndërsjellë midis palëve përkatëse të dy qeverive.

5. 1) Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr masat e nevojshme:

a) për t'u siguruar që Granti dhe interesi i akumuluar të livrohet tërësisht nga Llogaria, për t'u vendosur në dispozicion për blerjen e mallrave ose shërbimeve brenda një periudhe dymbëdhjetë-mujore nga data e ekzekutimit të Grantit, përveçse në rastin kur kjo periudhë shtyhet me marrëveshje të ndërsjellë nga autoritetet përkatëse të dy qeverive dhe për t'i kthyer vlerën e mbetur në Llogari qeverisë së Japonisë pas kësaj periudhe;

b) për t'u siguruar që tarifatat doganore, taksat e brendshme dhe detyrimet e tjera fiskale që mund t'u ngarkohen në blerje në Republikën e Shqipërisë produkteve dhe shërbimeve të përmendura në nënparagrafin 1, të paragrafit 2, nuk do të mbulohen nga Granti dhe interesi i akumuluar;

c) për t'u siguruar që Granti dhe interesi i akumuluar përdoret në mënyrë të përshtatshme dhe efektive, për të nxitur përpjekjet për zhvillim ekonomik e social;

d) t'i paraqesë, pa asnjë vonesë, qeverisë së Japonisë një raport të përgatitur me shkrim në një format të pranueshëm nga qeveria e Japonisë mbi transaksionet në Llogari, së bashku me kopjet e kontratave, faturat dhe dokumentet e tjera që lidhen me transaksionet përkatëse, kur Granti dhe interesi i akumuluar të jenë përdorur plotësisht për blerjen e produkteve dhe shërbimeve të përmendura nënparagrafin 1 të paragrafit 2 ose kur afati i përdorimit të Grantit dhe interesit të akumuluar skadon, në përputhje me dispozitat e pikës “a” më lart, ose me kërkesë të qeverisë së Japonisë; dhe

e) për të marrë si duhet në konsideratë aspektet mjedisore dhe sociale gjatë përdorimit të Grantit dhe interesit të akumuluar.

2) Sipas kërkesës, qeveria e Republikës së Shqipërisë i jep qeverisë së Japonisë informacionet e nevojshme mbi Grantin.

3) Produktet e blera në kuadrin e Grantit dhe interesit të akumuluar nuk rieksporthen nga Republika e Shqipërisë.

6. Për hollësitë e mëtejshme procedurale mbi zbatimin e marrëveshjes, autoritetet përkatëse të dy qeverive do të bien dakord nëpërmjet konsulimeve.

7. Të dyja qeveritë do të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo çështje që mund të lindë prej ose në raport me këtë marrëveshje.”

Më tej, kam nderin të propozoj që kjo Notë dhe Nota e Shkëlqesisë Suaj, në përgjigje të saj, që konfirmon në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë se marrëveshja paraprake përbën një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga qeveria e Japonisë të njoftimit me shkrim mbi përfundimin e procedurave të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Kam nderin e mëtejshëm që, në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, t'ju konfirmoj mirëkuptimin paraprak dhe të bie dakord se Nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo Notë, në përgjigje të saj, të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Qeveria e Japonisë të Njoftimit me shkrim mbi përfundimin e procedurave të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.”

Përfitoj nga rasti, për të siguruar edhe një herë Shkëlqesinë Tuaj për shprehjen e konsideratës sime më të lartë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Niko Peleshi

1) A/M
PROCESVERBALI I MIRATUAR MBI
HOLLËSITË PROCEDURALE

Duke iu referuar paragrafëve 2 dhe 6, të Shkëmbimit të Notave ndërmjet qeverisë së Japonisë (më poshtë i referuar si “Donatori”) dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë (më poshtë i referuar si “Marrësi”), në datë, data e nënshkrimit të E/N (më poshtë i referuar si “Shkëmbimi i Notave”), në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez që do të ofrohet, me qëllim dhënien e kontributit për nxitjen e përpjekjeve për zhvillim ekonomik dhe social të Marrësit (më poshtë i referuar si “Granti”), përfaqësuesit e Donatorit dhe të Marrësit dëshirojnë të mbajnë procesverbal mbi hollësitë procedurale të mëposhtme, pas marrëveshjes midis autoriteteve përkatëse të dy qeverive:



1. Lista e produkteve dhe shërbimeve dhe produkteve të kualifikuara

Produktet dhe shërbimet e përmendura në nënparagrafin 1, të paragrafit 2, të Shkëmbimit të Notave, me përjashtim të shërbimeve shoqëruese (më poshtë të referuara si “Komponentët”), janë ato që renditen në shtojcën I.

2. Vendet e origjinës që kualifikohen

Vendi i origjinës që kualifikohet, sipas referimit në nënparagrafin 3, të paragrafit 2, të Shkëmbimit të Notave, është Japonia, përveçse kur palët përkatëse të dy qeverive vendosin ndryshe me miratim të ndërsjellë.

3. Prokurimi

1) Granti dhe interesi i tij i akumuluar do të përdoren për blerjen e produkteve dhe shërbimeve të përmendura në nënparagrafin 1, të paragrafit 2, të Shkëmbimit të Notave, duke i kushtuar vëmendjen e duhur përdorimit në mënyrë ekonomike dhe efikase, përveçse kur autoritetet përkatëse të dy qeverive kanë rënë dakord ndryshe.

2) Në mënyrë që të garantohet veprimi në përputhje me këto kërkesa, Marrësi duhet të punësojë një agjent kompetent dhe të pavarur për blerjen e produkteve dhe shërbimeve të përmendura në nënparagrafin 1, të paragrafit 2, të Shkëmbimit të Notave.

Për rrjedhojë, Marrësi lidh një kontratë punësimi në parim, brenda tre muajve pas datës së hyrjes në fuqi të Shkëmbimit të Notave, me sistemin japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (më poshtë i referuar si “Agjenti”), për të vepruar për llogari të Marrësit brenda fushës së shërbimeve të Agjentit të parashikuar në shtojcën II.

3) Kontrata e punësimit në fjalë hyn në fuqi pas miratimit me shkrim nga Donatori.

4) Kontratat për blerjen e Komponentëve lidhen në jenë japonezë ndërmjet Agjentit dhe shtetasve japonezë (termi “shtetas japonez” në procesverbalin aktual të miratuar mbi hollësitë procedurale, nënkupton persona fizikë juridikë japonezë të kontrolluar nga persona fizikë japonezë).

5) Komponentët do të blihen në përputhje me “Udhëzimet e prokurimit të ndihmës me Grante për joprojekte”, që përcaktojnë, mes të tjerash, procedurat e kryerjes së tenderave që duhet të ndiqen, me përjashtim të rastit kur këto procedura janë të pazbatueshme apo të papërshtatshme.

6) Marrësi zbaton masat e nevojshme për shpejtësimin e përdorimit të Grantit dhe interesit të akumuluar, përfshirë lehtësimin e procedurave ekzistuese të importit.

4. Komisioni

1) Brenda dhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të Shkëmbimit të Notave, Donatori dhe Marrësi caktojnë përfaqësuesit e tyre që do të jenë anëtarë të komisionit konsultues (më poshtë i referuar si “Komisioni”), roli i të cilit është diskutimi i çdo çështjeje që lind prej ose në lidhje me Shkëmbimin e Notave. Menjëherë pas lidhjes së kontratës së punësimit, të përmendur në nënparagrafin 2, të paragrafit 3, më lart, Agjenti cakton përfaqësuesin e tij, i cili do të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit si këshilltar.

2) Komisioni kryesohet nga përfaqësuesi i Marrësit. Kur është e nevojshme, në mbledhjet e Komisionit mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësuesit e organizatave të tjera, përveç Agjentit, për të ofruar shërbime këshillimi.

3) Termat e referencës së Komisionit përcaktohen në shtojcën V.

4) Mbledhja e parë e Komisionit zhvillohet menjëherë pas miratimit nga Donatori të kontratës së punësimit, të përmendur në nënparagrafin 2, të paragrafit 3, më lart. Mbledhjet vijuese mbahen me kërkesë ose të Donatorit, ose të Marrësit. Agjenti mund të këshillojë Donatorin dhe Marrësin mbi nevojën për të thirrur mbledhjen e Komisionit.

5. Procedura e livrimit

Procedura e livrimit për blerjen e Komponentëve dhe shërbimeve shoqëruese, përfshirë tarifën e Agjentit në kuadrin e Grantit dhe interesit të akumuluar, është si më poshtë:

1) Marrësi (ose autoriteti i caktuar prej tij) dhe Banka në Japoni që përmendet në nënparagrafin 1, të paragrafit 3, të Shkëmbimit të Notave (më poshtë e referuar si “Banka”) lidhin një marrëveshje për transferimin e fondeve për të cilat Marrësi cakton Agjentin si përfaqësuesin që vepron në emër të Marrësit për të gjitha transferimet e fondeve tek Agjenti.

2) Agjenti i bën kërkesë Bankës për transferim fondesh për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për blerjen e Komponentëve të kualifikuar dhe shërbimeve shoqëruese, si dhe shërbimeve të Agjentit të parashikuara në shtojcën II.

Secila prej kërkesave shoqërohet me një preventiv të detajuar të shpenzimeve që do të



mbulohen nga fondet e transferuara dhe një kopje të miratimit të kontratës, përmendur në nënparagrafin 3, të paragrafit 3, më lart nga Donatori. Në të njëjtën kohë, një kopje e kërkesës dhe e preventivit i dërgohet Marrësit.

3) Bazuar në kërkesën e Agjentit, sipas nënparagrafit 2, më sipër, Banka njofton Marrësin për kërkesën e drejtuar nga Agjenti. Banka i paguan Agjentit vlerën nga llogaria e përmendur në nënparagrafin 1), të paragrafit 3, të Shkëmbimit të Notave (më poshtë e referuar si “Llogaria”), përveçse kur Marrësi e kundërshton këtë pagesë brenda dhjetë ditësh pune pas njoftimit nga Banka. Agjenti iu kryen pagesa furnitorëve nga fondet e marra (më poshtë të referuara si “Fonde të parapaguara”), në përputhje me kushtet e kontratës me ta.

Pas këtyre pagesave, Agjenti mund ta përdorë pjesën e mbetur të fondeve të parapaguara, nëse ka, për blerjen e Komponentëve dhe shërbimeve shoqëruese që kualifikohen, pa e transferuar vlerën në fjalë të Llogaria.

4) Procedura e rimbursimit

Kur vlera e përgjithshme e shumës së mbetur në Llogari dhe shumës së mbetur të fondeve të parapaguara (më poshtë të referuara bashkërisht si “Shuma e mbetur”) është më pak se 3% e Grantit dhe interesit të akumuluar, duke përfshirë tarifën e Agjentit, Marrësi mund t’i kërkojë Agjentit që t’ia rimbursojë shumën e mbetur Marrësit për pagesa që janë kryer nga Marrësi për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve që kontribuojnë për nxitjen e zhvillimit ekonomik e social të Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto pagesa të jenë kryer në datën e hyrjes në fuqi të Shkëmbimit të Notave ose pas saj. Vendet e kualifikuara të origjinës për këto produkte dhe/ose shërbime mund të jenë të gjitha vendet dhe zonat, me përjashtim të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht dispozitës së paragrafit 2 më sipër.

Kur Agjenti e konsideron kërkesën e Marrësit të drejtë, Agjenti i kërkon Bankës transferimin tek Agjenti të shumës së mbetur në llogari, duke i lëshuar Bankës një Autorizim për Blerje të Kualifikuar për Shumën e mbetur, të vërtetuar nga Marrësi dhe Agjenti, në përputhje me formularin në shtojcën IV. Pas këtij transferimi, Agjenti i rimbursos Marrësit shumën e mbetur.

5) Në lidhje me pikën “a”, të nënparagrafit 1, të paragrafit 5, të Shkëmbimit të Notave, livrimet nga

Llogaria bëhen brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore pas datës së ekzekutimit të Grantit dhe më pas nuk do të bëhet asnjë livrim, përveçse kur autoritetet përkatëse të dy qeverive kanë rënë dakord ndryshe.

6. Kthimi i shumës së mbetur

Në lidhje me pikën “a”, të nënparagrafit 1, të paragrafit 5, të Shkëmbimit të Notave, kur Donatori konstaton, pas marrjes së raportit përfundimtar bazuar në pikën “d”, të nënparagrafit 1, të paragrafit 5, të Shkëmbimit të Notave, se përdorimi i Grantit dhe interesit të akumuluar është i paplotë, ai njofton Marrësin për procedurat e kthimit të shumës së mbetur.

Marrësi i kthen shumën e mbetur Donatorit pa asnjë vonesë, nëpërmjet procedurave të përcaktuara më lart.

7. Përdorimi i Komponentëve

1) Marrësi zbaton masat e nevojshme:

a) për t’u siguruar që Komponentët të përdoren, në parim, nga përdoruesit fundorë, përfshirë vetë Marrësin, për qëllime jotregtare;

b) për t’u siguruar se Komponentët mirëmbahen dhe përdoren në mënyrë të përshtatshme dhe efektive për nxitjen e përpjekjeve për zhvillim ekonomik e social; dhe

c) për t’i dhënë konsideratën e duhur aspektit mjedisor dhe social në përdorimin e përmendur në pikën “a” më lart.

2) Me kërkesë të Donatorit, Marrësi informon Donatorin nëpërmjet Agjentit në lidhje me situatën e përdorimit të përmendur në nënparagrafin 1/a më sipër.

Tiranë, xxxx2015

2) A/M I

SHTOJCË I LISTA E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE TË KUALIFIKUARA (KOMPONENTËT)

- Automjete të gjeneratës së ardhshme të përshtatshme nga pikëpamja mjedisore, si Automjetet Hibride (HV), Automjete Elektrike Hibride të Operuara me Energji (PHEV), Automjete Elektrike (AE) dhe Automjete me Naftë “Diesel” të Pastër/të Papërzier (DP).

- Pajisje shoqëruese, materiale, shërbime inxhinierie civile, trajnimi dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e



automjeteve të gjeneratës së ardhshme të përshtatshme nga pikëpamja mjedisore.

- Shërbime konsulence.

3) A/M II-V

SHTOJCË II

FUSHA E SHËRBIMEVE TË AGJENTIT

1. Mbledhja e informacionit të nevojshëm dhe ofrimi i këshillave për Marrësin, kur është e nevojshme, për Komponentët që duhen blerë, bazuar në kërkesën e Marrësit, përfshirë disponimin në gjendje të këtyre Komponentëve.

2. Ofrimi i informacionit dhe i këshillimit në mbledhjet e Komisionit.

3. Garantohet, kur është nevoja, që Marrësi dhe përdoruesit fundorë t'i kuptojnë plotësisht procedurat që duhen ndjekur.

4. 1) Përgatitja e specifikimeve teknike të Komponentëve për Marrësin, përfshirë, kur është e nevojshme, diskutime të hollësishme me përdoruesit fundorë.

2) Përgatitja e dokumenteve të tenderit, në përshtatje me llojin dhe vlerën e Komponentëve që do të blihen;

3) Shpallja e ofertave, kur të zhvillohet një procedurë me konkurs, për formulimin e të cilave duhet të bien dakord Donatori dhe Marrësi;

4) Vlerësimi i ofertave, përfshirë konsideratat teknike dhe financiare;

5) Paraqitja e rekomandimeve të Marrësit për miratim, për kryerjen e porosisë te furnitorët.

5. Marrjen dhe vënien në përdorim të fondeve të parapaguara, në përputhje me kontratën e punësimit me Marrësin, të përmendur në nënparagrafin 2, të paragrafit 3, të “Procesverbalit të miratuar mbi hollësitë procedurale”.

6. Bisedimet dhe lidhja e kontratave me furnitorët, përfshirë kushtet e kënaqshme të pagesës, transportimit dhe inspektimit.

7. Kontrollon ecurinë e furnizimeve, për t'u siguruar për respektimin e datave të dërgesës.

8. I ofron Marrësit dhe përdoruesve fundorë dokumente që përmbajnë informacion të hollësishëm mbi ecurinë e porosive, njoftimin e porosive të bëra, ndryshimet në kontrata, informacion mbi dërgesat, dokumentet e transportit etj.

9. Pagesa e furnitorëve nga fondet e parapaguara.

10. I paraqet Donatorit dhe Marrësit dokumentet e mëposhtme:

1) Autorizimin për blerjen e kualifikuar, sipas shtojcës III;

2) Faturë pro-forma (faturë e përmbledhur e dërguar paraprakisht nga shitësi për blerësin në lidhje me një dërgesë të caktuar).

11. Përgatitja e raporteve tremujore mbi situatën për Donatorin dhe Marrësin, ku jep informacion mbi kërkesat, porositë, statusin e porosisë, vlerat dhe dërgesën.

12. I paraqet Donatorit dhe Marrësit pasqyrat financiare tremujore, duke analizuar me detaje bilancin në raport me Grantin dhe interesin e akumuluar dhe të gjitha livrimet për tremujorin.

13. Transferimi i mbetjes së fondeve të parapaguara në Llogari, pas periudhës së përmendur në nënparagrafin 5, të paragrafit 5, të “Procesverbalit të miratuar mbi hollësitë procedurale”

14. I paraqet Donatorit një raport të përgjithshëm vlerësimi, përfshirë hollësi mbi të gjithë Komponentët e dërguar, vendin e origjinës, datën e dërgesës, vlerën e Komponentëve (duke përfshirë tarifatat përkatëse) dhe shumën e përgjithshme të livruar dhe të mbetur.

SHTOJCË III

AUTORIZIMI PËR BLERJEN E KUALIFIKUAR

Data:

Nr. ref.:

Për të interesuarit:

Duke iu referuar faturës proforma bashkëlidhur, ne vërtetojmë se prokurimi është në përputhje me të gjitha kushtet dhe kriteret e shkëmbimit të notave ndërmjet qeverisë së Japonisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë, data e nënshkrimit të E/N, si dhe me “Procesverbalin e miratuar mbi hollësitë procedurale” ndërmjet autoriteteve përkatëse të dy qeverive, datë, data e nënshkrimit të A/M.

Sa vijon janë faktet kryesore në lidhje me prokurimin.

1. Metoda e prokurimit

(Vendosni X në vendin e duhur)

a) _____: Procedura me konkurs

b) _____: Procedura e kufizuar



- c) _____: Blerje të vogla
d) _____: Procedura e drejtpërdrejtë

2. Komponentët

a) Emërtimet e Komponentëve:

b) Origjina:

3) Kostoja e Komponentëve dhe shërbimeve shoqëruese

a) Komponentët:

b) Pagesa e transportit:

c) Sigurimi i transportit detar:

d) Tarifat e Agjentit:

e) Totali (a+b+c+d):

4. Furnitori

Emri:

Adresa:

Nënshtetësia:

(Vendi ku është vendosur dhe regjistruar furnitori)

5. Marrësi i ngarkesës

Emri:

Adresa:

(Nënshtetësi)

Agjenti

Emri, titulli

SHTOJCË IV
AUTORIZIMI PËR BLERJE TË
KUALIFIKUAR
PËR SHUMËN E MBETUR
(PROCEDURA E LIVRIMIT)

Datë:

Nr. ref.:

Duke iu referuar urdhërpagesës, i nënshtetësi, i nënshtetësi, i nënshtetësi vërteton se blerja në lidhje me urdhërpagesën në fjalë, siç renditet më poshtë, është në përputhje me të gjitha kushtet dhe kriteret përkatëse të Shkëmbimit të Notave ndërmjet qeverisë së Japonisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë, data e nënshtetësit të E/N, si edhe me “Procesverbalin e miratuar mbi hollësitë procedurale” ndërmjet autoriteteve përkatëse të dy qeverive, datë, data e nënshtetësit të A/M.

Përfaqësuesi i nënshtetësi i Marrësit vërteton më tej se Marrësi nuk ka depozituar kërkesë për rimbursim, bazuar në shkëmbimin e notave, në fjalë dhe për asnjë marrëveshje tjetër financimi nga burime të tjera të ndihmës zyrtare në lidhje me ndonjë shumë të kërkuar për rimbursim, si ajo që pasqyrohet në urdhërpagesë.

Në vijim janë faktet kryesore përkatëse në lidhje me prokurimin.



1.	2.	3.	4.	5.	6.	7.	8.	9.
Transaksioni	Blerësi	Furnitori (emri)	Nënshtetësia e furnitorit	Produktet dhe/ose shërbimet	Origjina	Data e pagesës	Vlera e pagesës	Metoda e prokurimit
1.								
2.								
3.								
4.								
.								
.								
.								

Dokumentet vijuese (në një kopje) janë bashkëlidhur për secilin nga transaksionet e mësipërme.

- a) Letra përmbledhëse e hartuar nga banka negociuese/paguese;
- b) Dokumenti, fatura e pakos postare ose e deklaratës së dorëzimit në rrugë ajrore;
- c) Fatura.

Nënshkrimi i autorizuar
(Marrësi)
Emri, titulli

Nënshkrimi i autorizuar
(Agjenti)
Emri, titulli



SHTOJCË V

TERMAT E REFERENCËS SË KOMISIONIT

1. Formulimi i një plani kohor për një përdorim të shpejtë dhe efektiv të Grantit dhe interesit të akumuluar;

2. Shkëmbimi i mendimeve mbi shpërndarjen e Grantit dhe interesit të akumuluar, si edhe mbi përdoruesit e mundshëm fundorë;

3. Identifikimi i problemeve që mund të shkaktojnë vonesa në përdorimin e Grantit dhe interesit të akumuluar dhe shqyrtimi i zgjidhjeve për këto probleme;

4. Shkëmbimi i mendimeve mbi bërjen publike të përdorimit të Grantit dhe interesit të akumuluar;

5. Diskutimi i çështjeve të tjera që mund të lindin prej shkëmbimit të notave ose në lidhje me të.

PROCESVERBALI I DISKUTIMEVE

Në lidhje me Shkëmbimin e Notave ndërmjet qeverisë së Japonisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin ekonomik japonez të ofruar me qëllim dhënien e kontributit për nxitjen e përpjekjeve për zhvillim ekonomik e social nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, datë D (më poshtë i referuar si “shkëmbimi i notave”), përfaqësuesit e delegacionit japonez dhe të delegacionit shqiptar, dëshirojnë të mbajnë procesverbal mbi sa vijon:

1. Në lidhje me paragrafin 2 të shkëmbimit të notave, përfaqësuesi i delegacionit japonez deklaroi si më poshtë:

Qeveria e Japonisë kupton se qeveria e Republikës së Shqipërisë do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar çdo ofertë, dhuratë a pagesë, marrje në konsideratë apo përfitim që do të interpretohej si praktikë korrupsioni në Republikën e Shqipërisë, e cila ndodh si detyrim apo shpërblim për caktimin e kontratave të cilave iu referohet Agjenti në nënparagrafin 2, të paragrafit 3, të “Procesverbalit të miratuar mbi hollësitë procedurale” të shkëmbimit të notave, që mund të lidhen me qëllim blerjen e produkteve dhe shërbimeve, përmendur në paragrafin 2 të Shkëmbimit të Notave.

2. Në lidhje me nënparagrafin 2, të paragrafit 5, të Shkëmbimit të Notave, përfaqësuesit e delegacionit japonez deklaruan se qeveria e Japonisë kupton se:

a) informacioni i nevojshëm përfshin të dhëna mbi praktika korruptive në lidhje me Grantin e përmendur në paragrafin 1 të Shkëmbimit të Notave; dhe

b) Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t’iu garantojë trajtim të drejtë burimeve të këtij informacioni.

3. Përfaqësuesit e delegacionit shqiptar deklaruan se delegacioni shqiptar nuk ka asnjë kundërshtim ndaj deklaratës së përfaqësuesit të delegacionit japonez, të përmendur më lart.

Tiranë, xxxx, 2015

LIGJ

Nr. 116/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE,
“PËRFITUESI”, E FONDIT SHQIPTAR
TË ZHVILLIMIT, “AGJENCIA
ZBATUESE E PROJEKTIT”, DHE KFW
FRANKFURT AM MAIN, “KFW”, PËR
PËRGATITJEN E PROJEKTIT DHE
STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT PËR
NDËRTIMIN/RINDËRTIMIN E
SISTEMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË
NË ZONAT RURALE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, “Përfituesi”, e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, “Agjencia zbatuese e projektit”, dhe KfW Frankfurt amMain, “KfW”, për përgatitjen e projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9307, datë 3.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJA E FINANCIMIT DHE E PROJEKTTIT

E DATËS 26.6.2015, NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (PËRFITUESI) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTTIT), PËR 670,000.00 EURO PËR “PËRGATITJEN E PROJEKTTIT DHE STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT PËR NDËRTIMIN/RINDËRTIMIN E SISTEMEVE TË UJËSJELLËSVE NË ZONAT RURALE” (BMZ ID: 2020 61 695)

Preambulë

Në bazë të Marrëveshjes së Zbatimit me referencë aplikimi të projektit WB10-ALB-ENV-01, të datës 28 korrik 2014 ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në dakordësi me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI) - BERZH dhe BEI, duke vepruar si bashkëdrejtuesit e Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (EWBJF) - dhe KfW-së (Marrëveshja e Zbatimit) dhe në përputhje me miratimin e Komitetit Drejtues të Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF), të datës 4 dhjetor 2013 (Miratimi) për të financuar “Përgatitjen e Projektit dhe Studimeve të Fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale” (Projektpropozimi),

Përfituesi, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW hyjnë në Marrëveshjen e Financimit si më poshtë:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja do t'i japë Përfituesit një

Kontribut Financiar që nuk kalon shumë prej 670,000.00 eurosh, duke përfshirë çdo shumë paradhënieje që duhet të jepet në përputhje me nenin 1.1, paragrafi i fundit i tij, si dhe interesin e shtuar plotësisht para disbursimit në llogarinë e Grantit të mbajtur nga KfW, totali i të cilës përbën “Kontributin Financiar”.

Ky Kontribut Financiar nuk është i kthyesëm përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

Sipas Marrëveshjes së Zbatimit, llogaritë e mëposhtme janë zbritur nga Granti prej 750,000.00 eurosh i Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF):

a) Pagesa e KfW-së për shërbimet e saj si Institucion Financiar Ndërkombëtar Drejtues, në shumë prej 30,000.00 eurosh (4 % e angazhimit të WBIF-së), siç përcaktohet në nenin 4.1, Kushtet e Veçanta të Marrëveshjes së Zbatimit;

b) Kostoja e Auditimit (Kosto Auditimi) e shpenzuar nga KfW-ja në përputhje me kërkesat e auditimit të jashtëm vjetor të llogarisë së Grantit WBIF të administruar nga KfW-ja sipas nenit 6, Kushtet e Veçanta, dhe nenit 3.1.2, shtojca B, Kushtet Standarde të Marrëveshjes së Zbatimit, që pritet të arrijë shumë prej 25,000.00 eurosh dhe që për të cilën KfW do të rimburohet nga fondet e granteve.

c) Pagesa e shërbimeve të Agjentit të Tenderit (Kostoja e Tenderimit) që pritet të arrijë shumë 25,000.00 euro dhe për të cilën KfW-ja do të rimburohet nga fondet e Grantit sipas shtojcës A të Marrëveshjes së Zbatimit.

Shumat sipas “b” dhe “c” (shumat e mbajtura) mbeten në llogarinë e KfW-së dhe rimburohen sipas ecurisë së shërbimeve përkatëse. Në rast se shumat aktuale për shpenzimet sipas “b” dhe “c” janë më të vogla se Shumat e Mbajtura, fondet e tepërta, përfshirë interesin e shtuar nga llogaria e Grantit (nëse ka) do t'i jepen Përfituesit për t'u përdorur për Projektin siç përshkruhet më poshtë, me kusht që KfW-ja dhe Përfituesi të bien dakord mbi mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.2 Përfituesi e kanalizon Kontributin Financiar plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor Kontributin Financiar vetëm për:



i) përgatitjen e projektit; dhe ii) studimet e fizibilitetit për ndërtimin ose rindërtimin e sistemit të ujësjellësve në zonat rurale, ku “i” dhe “ii” së bashku do të quhen “Projekti”. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga Kontributi Financiar me marrëveshje të veçantë (Marrëveshja e Veçantë).

1.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera publike mbulohen nga Përfituesi ose Agjencia e Zbatimit të Programit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga Kontributi Financiar.

Neni 2

Kanalizimi i Kontributit Financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit

2.1 Përfituesi e kanalizon Kontributin Financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një Grant të pakthyesëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë të Kontributit Financiar, Përfituesi i dërgon KfW-së një përkthim të vërtetuar në anglisht ose gjermanisht të marrëveshjes së veçantë të financimit, të përcaktuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Kontributit Financiar nuk përbën ndonjë detyrim për Agjencinë e Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrime pagese sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Kontributin Financiar në pajtim me ecurinë e Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja bien dakord për procedurën e disbursimit, veçanërisht për provat që vërtetojnë se fondet e disbursuara nga Kontributi Financiar janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të kryerjes së disbursimeve pas datës 1.8.2017.

Neni 4

Pezullimi i Disbursimeve dhe i Shlyerjes

4.1 KfW-ja nuk mund t'i pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Përfituesi nuk arrin të plotësojë detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes së Veçantë që është pjesë e kësaj Marrëveshjeje;

c) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk është e aftë të provojë se Kontributi Financiar është përdorur për qëllimin e caktuar; ose

d) Lindin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë apo vënë seriozisht në rrezik zbatimin, funksionimin apo qëllimin e Projektit;

e) BERZH-i nuk i ka alokuar KfW-së financimin e kërkuar sipas Marrëveshjes së Zbatimit; ose

f) Marrëveshja e Zbatimit pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë ose ndërpritet.

4.2 Nëse ka ndodhur cilado nga situatat e përcaktuara në nenin 4.1/b/c dhe nuk është shmangur brenda një periudhe të caktuar nga KfW-ja, periudhë, e cila gjithsesi do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja atëherë ka të drejtë:

a) në rastin e specifikuar në nenin 4.1/b, të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.1/c, të kërkojë kthimin e menjëhershëm të atyre shumave për të cilat Agjencia Zbatuese e Projektit nuk është e aftë të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrime të tjera publike, që krijohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me arritjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe kostot e transfertave dhe konvertimeve që lindin në lidhje me disbursimin e Kontributit Financiar.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe që autorizohen prej tij nëpërmjet ekzemplarëve të firmave të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë Përfituesin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe ata persona që caktohen prej tij ose



saj për KfW-në dhe janë të autorizuar me ekzemplarë të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj, e përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Tagri i përfaqësimit nuk skadon deri në revokimin shprehimisht nga përfaqësuesi i përfituesit të autorizuar në momentin që është marrë nga KfW-ja.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklarim i bërë nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë konsiderohet e marrë nëse ka arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në një adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse sipas njoftimit drejtuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
(Republika Federale e Gjermanisë)
Faks: +49 69 7431 2944

Për
Përfituesin: Ministria e Financave
Republika e Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Tiranë
Faks: + 355 4 222 8494

Për
Agjencinë Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Zbatuese të Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10
Projektit: Tiranë, Republika e Shqipërisë
Faks: +355 4 234 885

6.3 Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që mund të ndikojnë vetëm në marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit nuk kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Neni 7 Projekti

7.1 Agjencia Zbatuese e Projektit

a) përgatit, zbaton, operon dhe ruan Projektin në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike dhe kryesisht në pajtim me konceptin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) u ngarkon konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar përgatitjen e Projektit dhe studimeve të fizibilitetit për ndërtimin/rindërtimin e sistemeve të ujësjellësve në zonat rurale dhe i ngarkon zbatimin e projektit kompanive të kualifikuara;

c) mban ose kujdeset për mbajtjen e doku-

menteve dhe regjistrave që përcaktojnë qartë koston e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e kryera nga Kontributi Financiar;

d) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së, Komisionit Evropian, Gjykatës së Auditëve të Bashkimit Evropian, BEI-t ose çdo përfaqësuesi tjetër të caktuar nga Komisioni Evropian, që në çdo kohë të inspektojnë të gjitha dokumentet dhe regjistrat, si dhe çfarëdolloj dokumentacioni tjetër që lidhet me zbatimin e Projektit, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet e lidhura me të;

e) i siguron KfW-së çfarëdo informacioni dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin, ecurinë e mëtejshme të tij, siç mund të kërkohej nga KfW-ja;

f) siguron se në rastet e referimit të Projektit, qoftë kjo në dokumentet zyrtare ose të informimit publik, duhet të njihet dhe bëhet publik fakti se aktivitete të tilla janë financuar nëpërmjet burimeve të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (EWBJF) dhe të zbatuar nga KfW-ja si institucion drejtues financiar;

g) siguron që të gjitha publikimet, duke përfshirë edhe raportet specifike për zbatimin e Projektit të financuar me këtë Kontributit Financiar, të mbajnë shënimin e mëposhtëm: “Ky dokument është hartuar me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor në kuadër të Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor. Pikëpamjet e shprehura këtu janë të (emri i autorit) dhe, si rrjedhojë, në asnjë mënyrë nuk mund të merren për të pasqyruar opinionin zyrtar të Kontribuuesve të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor apo të BERZH-it, si bashkëdrejtues i EWBJF-së”.

7.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë në lidhje me nenin 7.1 me Marrëveshje të Veçantë.

7.3 Përfituesi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit, duhet të:

a) sigurojnë financim të plotë të projektit dhe, nëse iu kërkohej, i japin KfW-së prova që vërtetojnë se kostoja që nuk paguhet nga Kontributi Financiar është e mbuluar; dhe

b) me iniciativë të tyre informojnë KfW-në për të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit;



c) t'i ofrojnë KfW-së të gjithë atë informacion dhe regjistra mbi projektin dhe përparimin e tij të mëtejshëm, nëse e kërkon KfW-ja;

d) të garantojnë që pronësia, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe profesionale, titullit që janë rrjedhojë e zbatimit të Shërbimeve të Ekspertëve, si dhe raportet, dokumentet dhe materiale të tjera që lidhen me këtë projekt, i takojnë vetëm KfW-së, ndërsa Përfituesi do të ketë të drejtën e përdorimit falas të të gjitha raporteve, dokumenteve dhe materialeve të përfuara nga zbatimi i Programit;

e) njohin të drejtën e KfW-së, Komisionit Evropian, Gjykatës së Auditëve të Bashkimit Evropian ose BEI-t për të rishikuar të gjitha dokumentet që lidhen me Projektin, duke respektuar rregullat e zbatueshme mbi konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale; dhe

f) sigurojnë që Komisioni Evropian, Gjykata e Auditëve të Bashkimit Evropian dhe/ose BEI të mund të kryejnë misionet vlerësimi dhe kontrolli në lidhje me Projektin e financuar nga ky Kontribut Financiar.

7.4 Përfituesi asiston Agjencinë e Zbatimit të Projektit në pajtim me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare për zbatimin e Projektit dhe në përmbushje të detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, i jep Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e tij.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Përfituesi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit garantojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e çdo kontrate për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen dhe kërkimin e disbursimeve të shumave të huas, të mos kërkojnë, prezumojnë, japin, dhurojnë, premtojnë ose marrin premtim për pagesa të paligjshme dhe avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

Gjithashtu, Përfituesi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit parandalojnë shfaqjen e praktikave të ndaluara, siç është përcaktuar në nenin 8, shtojcën B, Kushtet Standarde të Marrëveshjes së Zbatimit apo çdo aktiviteti tjetër të paligjshëm në lidhje me përdorimin e Kontributit Financiar.

8.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, që është i nevojshëm për këtë qëllim.

Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të vet. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit:

a) burimet e veta të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose shumat e investuara në financimin e Projektit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë joshteruese nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

b) kapitali aksionar i Agjencisë së Zbatimit të Projektit nuk do të jetë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë joshteruese nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të përfshihet në përfundimin, zotërimin ose përdorimin e pasurisë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht kjo listë joshteruese nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të përfshihet në financimin e terrorizmit;

8.3 KfW-ja ka të drejtë t'i japë Komisionit Evropian, Gjykatës së Auditëve të Këshillit Evropian, BERZH-it, BEI-t dhe Republikës Federale Gjermane çdo informacion në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, si dhe në lidhje me zbatimin e Projektit. Përfituesi do të sigurojë që çdo nënpërfitues dhe kontraktues të cilit Përfituesi i transferon fonde drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte nga ky Kontribut Financiar, e njeh këtë të drejtë dhe jep aprovimin e tij.

8.4 Nëse një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara prej saj. Çdo boshllëk që rrjedh prej saj mbulohet nga një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.



8.5 Çdo amendament ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe duhet të bihet dakord sipas rregullave nga të gjitha palët. Ministri i Financave është i autorizuar që të nënshkruajë çdo amendament, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendamentet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërinë nuk do të kërkojnë miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

8.6 Përfituesi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të transferojnë, lënë peng ose rëndojnë me hipotekë asnjë prej pretendimeve nga kjo Marrëveshje.

8.7 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes së detyrimit është Frankfurt am Main.

8.8 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së, Përfituesit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit mbarojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së dobishme të projektit por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje.

Hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main	Frankfurt am Main
Në datën..., të muajit... 2014	Në datën..., të muajit... 2014
Për KfW-në	

Christoph Tiskens	Heike Schwarzl
Drejtuues Departamenti	Drejtuues i Lartë Projekti
Tiranë	
Në datën..., të muajit...2014	
Për Republikën e Shqipërisë	

Z. Shkëlqim Cani
Ministër i Financave

Tiranë
Në datë..., të muajit...2014
Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Z. Benet Beci
Drejtor Ekzekutiv

DEKRET

Nr. 9294, datë 30.10.2015

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Sanije Hamit Myderizi
2. Agron Pal Gjini
3. Xhovalin Berti Dizdari
4. Ana Berti Dizdari
5. Christian Albert Prifti
6. Zvezdan Leko Kërstoja
7. Tizjana Tonin Demaj
8. Lorenc Reshat Shahinas
9. Miklovan Mark Gjonaj
10. Elsaid Skender Curaj
11. Suada Seidin Tula (Dashi)
12. Valbona Hasan Lani (Laçe)
13. Haziz Sali Seferi
14. Vuke Zarija Popović (Popaj)
15. Julka (Julijana) Bllago Popović (Malaj)
16. Sladjana Mirko Zlatičanin
17. Snezhana (Valbona) Ivo Matanović (Mikuliq)
18. Jorgovan (Adriatik) Petko Sekuliq (Ashkja)
19. Irena Mirko Brajović (Brajović)
20. Lirjane Drago Radusinović (Mikuliq)
21. Ina Piro Bica

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 9295, datë 30.10.2015
PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Tatiana (Tatjana) Andrej Balliu (Çernova)
2. Labinot Daut Mustafaj
3. Fatos Rexhep Kuçi
4. Xhevxhet Bahtir Krasniqi
5. Yaşar Ekrem Özer
6. Kujtesa Ruzhdi Kortoçi (Islama)
7. Kanber Süleyman Güneşten

8. Lendita Feim Reka Hamzaraj (Reka)
9. Emine Zehra Mehmet Yaşar Abakay (Özkanlı)
10. Ergin Sami Hajredini
11. Yasin Hüseyin Gündüz
12. Shemsi Rrahman Rrahmani
13. Agron Kol Shtufi
14. Nexhmije Ilaz Blaku Selmani (Blaku)
15. Anita Prend Mjetaj (Kacoli)
16. Xhevxhet Rufat Shkodra (Shala)
17. Chukwuka Charles Samuel Ofojeh
18. Drilon Nexhdet Zeka
19. Kastriot Ismet Korça (Korça)
20. Muhammet Durmuş İşler
21. Havva Mehmet İşler (Yıldız)
22. Panagiotis Asterios Giannarakis
23. Valina Shefki Muçolli
24. Ennur Djengis (Xhengis) Totre

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

Saktësim gabimi material

Në vendimin nr. 858, datë 21.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2015, për çështjen “Metalla dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (aplikimet nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 29.10.2015, f. 12592,

Kolona 3 e shtojcës 1, “Lista e aplikantëve”, ishte:

Nr.	Çështja dhe numri	Emri i aplikantit (ve) (viti i lindjes)	Shteti rezident	Përfaqësuar nga	Data e kërkesës
1.	<i>Metalla</i> , nr. 30264/08	Nezmi Metalla (1943) Bujar Metalla (1956)	Shqipëri	E. Muharremaj, Avokat	13 Qershor 2008
2.	<i>Bushati</i> , nr.42120/08	Genc Bushati (1944)	Shqipëri	B. Muslija, Avokat	9 Gusht 2008
3.	Metalla dhe të tjerë nr. 54403/08	Nezmi Metalla (1943) Bujar Metalla (1956) Shyqyri Metalla (1947)	Shqipëri	E. Muharremaj, Avokat	8 Tetor 2008
4.	<i>Metalla dhe të tjerë</i> , nr. 54411/08	Besnik Metalla (1961) Ferik Metalla (1969) Dhurata Metalla, née Duka (1956) Sanije Sinjari (1928) Fiqirete Gashi (1931)			



dhe bëhet:

Nr.	Çështja dhe numri	Emri i aplikantit (ve) (viti i lindjes)	Shteti rezident	Përfaqësuar nga	Data e kërkesës
1.	<i>Metalla</i> , nr. 30264/08	Nezmi Metalla (1943) Bujar Metalla (1956)	Shqipëri	E. Muharremaj, Avokat	13 Qershor 2008
2.	<i>Bushati</i> , nr. 42120/08	Genc Bushati (1944)	Shqipëri	B. Muslija, Avokat	9 Gusht 2008
3.	<i>Metalla dhe të tjerë nr.</i> 54403/08	Nezmi Metalla (1943) Bujar Metalla (1956) Shyqyri Metalla (1947) Besnik Metalla (1961) Ferik Metalla (1969)	Shqipëri	E. Muharremaj, Avokat	8 Tetor 2008
4.	<i>Metalla dhe të tjerë</i> , nr. 54411/08	Dhurata Metalla, mbiemri i vajzërisë Duka (1956) Sanije Sinjari (1928) Fiqirete Gashi (1931)			

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë